

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 16
03.07.2014

NR. VENDIMI 14
04.07.2014

V E N D I M
për
“SEKUESTRIMIN E PASURISË”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga :

Gjyqtar : BARDHYL DHAMA

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Olivia Myftiu**, më dt.04.07.2014, ora 10.30, mori në shqyrtim në séancë gjyqësore jo publike kërkesën penale nr.16 akti me:

KERKUES: Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga prokurori Edvin Kondili.

KUNDER: Shtetasit nën hetim: **-A.S.**, i biri i G. dhe i Q., i datëlindjes xxx, lindur ne xxx, xxx dhe banues ne xxx.

OBJEKTI: “Sekuestrim pasurie”

- I- *Sekuestrimin e shumës monetare të shtetasit A.S.;*
 - *Prej xxx GBP (Paund Britanik) që ndodhen në Banken xxx, në llogari të këtij shtetasi.*
- II- *Për Administrimin e kësaj pasurie të ngarkohet z.K.Xh., i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.*
- III- *Për ekzekutimin e kësaj sekuestroje te ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor, xxx.*

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar në prani të prokurorit Edvin Kondili që kërkoi pranimin e kërkesës e, konkretisht:

- 1. Sekuestrimin e shumës monetare të shtetasit A.S.;
Prej xxxGBP (Paund Britanik) që ndodhen në Bankën xxx, në llogari të këtij shtetasi.*
- 2. Për Administrimin e kësaj pasurie të ngarkohet z.Kleant Xholi, i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të*
- 3. Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.
Për ekzekutimin e kësaj sekuestroje te ngarkohet Zyra e Përmbartimit Gjyqësor, xxx.*

Gjykata si mori në shqyrtim aktet e provat e paraqitura;

VËREN SE:

Me datë xxx në sekretarinë e kësaj Gjykate është depozituar për gjykim kërkesa penale e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me objektin e lartpërmendur, mbi procedimin pasuror nr.xx të vitit xxx.

Rezulton se, Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, më datë xxx ka regjistruar procedimin pasuror nr.xx të vitit xxx, në ngarkim të shtetasit A.S. Në ngarkim të këtij shtetasi me datë xxx, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx, ka filluar procedimi penal nr.xxx të vitit xxx, pasi dyshohet të ketë kryer veprën penale të “Pastrimit te produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Mbi këtë bazë, provohet se në datë xxx, Prokuroria për Krime të Rënda - Tiranë, ka regjistruar procedimin pasuror nr.xx, në ngarkim të shtetasit A.S. Nga prokuroria pretendohet se i hetuari A.S., në bazë të nenit 3/1 germa “d” të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Njëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, është subjekt i hetimit pasuror.

Rezulton se për këtë shtetas, Prokuroria për Krime të Rënda ka kërkuar sekuestrimin e pasurisë së luajtshme, vlera monetare e pasqyruar në llogarinë përkatëse, me gjëndje prej xxxGBP (Paund Britanik), pranë Bankës xxx, në llogari të këtij shtetasi. Sipas palës kërkuese/prokurorit, për këtë vlerë monetare në depozitën bankare në emër të shtetasit A.S., është vendosur sekuestro preventive në funksion të procedimit penal nr xxx, të vitit xxx, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx. Në aktet që i janë bashkëngjitur kërkesës së prokurorit, nuk disponohet asnjë vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, në lidhje me

vendosjen e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive” për këtë pasuri. Në këto kushte, gjykata e çmon të pabazuar në prova kërkesën e prokurorit, për të disponuar pezullimin e zbatimit të masës së sekuestros preventive, në bazë të nenit 5 pika ‘3’ të ligjit 10192, datë 03.12.2009. Në kërkimin e tij, prokurori pretendon se, ekziston rreziku real dhe potencial që pasuria e mësipërme të tjetërsohet apo të humbasë, prandaj në bazë të nenit 11/1 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, duhet vendosur sekuestro mbi këtë pasuri.

Gjykata në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj kërkesë çmon se, kjo kërkesë është e bazuar në ligj dhe në prova, ndaj si e tillë duhet te pranohet.

Gjykata si dëgjoji pretendimet e prokurorit dhe shqyrtoi provat e aktet bashkëngjitur kërkesës, vlerësoi se i hetuari A.S. është subjekt i ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Në bazë të nenit 3/1/’d’ të këtij ligji, gjykata çmon se ndaj të hetuarit në këtë procedim pasuror ekziston një dyshim i mbështetur në indicie se, ai ka konsumuar elementët e veprës penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 të K.Penal. Sipas akteve të ndodhura në dosje, në ngarkim të të hetuarit A.S., ka filluar procedimi penal mbi bazën e informacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, e cila ka verifikuar çeljen e një llogarie rrjedhëse individuale nga ana e tij. Pas vendosjes së marrëdhënies së biznesit në favor të tij, në datë xxx, në llogarinë rrjedhëse të shtetasit A.S. ka mbërritur një transfertë nga jashtë, në shumën xxx GBP (paund britanik), ndërkohë që nuk ka patur asnjë detaj në fushën e përshkrimit, për të kuptuar qëllimin e kryerjes së kësaj transferte. Nga verifikimet e kryera nga ana kësaj drejtorie, ka rezultuar që dërgues i transfertës është shtetasi O.M.K., i cili figuron në listën e personave të përfshirë në akte terroriste në xxx. Nga verifikimet paraprake të kryera deri tani nga ana e organit të akuzës, për shtetasin A.S., nuk provohet që ai të ketë patur aktivitetet ekomomik të tillë që të justifikojnë fitimin e pasurisë së mësipërme.

Neni 11/1/a te ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, parashikon: *“Me kërkesë të motivuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive të personave, sipas nenit 3 të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie që tregon se personi mund të jetë i përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura, që*

nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruar dhe as nuk justifikohen prej tyre dhe kur:

a) ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji;

b) ka dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale”.

Gjykata, çmon se të dhënat e mbledhura dhe të verifikuara deri në këto momente, janë të mjaftueshme si indicie, për të vendosur sekuestrimin e pasurisë ‘llogari bankare’ në emër të shtetasit A.S. Në marrjen e këtij vendimi gjykata, vlerëson se ekziston rreziku real për tjetërsimin e kësaj pasurie që kërkohet të sekuestrohet, nisur edhe nga natyra e aktivitetit kriminal për të cilin dyshohet i hetuari në këtë procedim pasuror. Në bazë të nenit 130 e vijues të K.Pr.Civile, si dhe në referim të nenit 14 të ligjit të sipërcituar, gjykata urdhëron sekretarinë gjyqësore të kryejë veprimet e njoftimit.

Për ekzekutimin e këtij vendimi, mbështetur në nenin 14 të ligjit nr.10192 datë 03.09.2009, urdhërohet Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor Tirane, ndërsa për administrimin e kësaj pasurie ngarkohet z.*Kleant Xholi*, i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në baze të neneve 212 e vijues të K.Pr.Civile nenet 3/1/d; 5; 7; 11/1/a, 12,14,15 e vijues të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Njëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”

V E N D O S I

-Pranimin e kërkesës së Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë duke urdhëruar:

- I Sekuestrimin e llogarisë bankare të shtetasit A.S., të ndodhur në Bankën xxx Shqipëri, në shumën prej xxx GBP (Paund Britanik).*
- II Për Administrimin e kësaj pasurie të ngarkohet z. Kleant Xholi, i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.*

*III. Për ekzekutimin e kësaj sekuestroje te ngarkohet Zyra e Përmbarrimit
Gjyqësor, xxx.*

-Urdhërohet sekretaria gjyqësore e kësaj gjykate të dërgojë menjëherë **kopje të këtij vendimi në Institucionet e sipërme.**

-Kundër vendimit lejohet të bëhet ankim brenda afatit të parashikuar në
K.Pr.Civile në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë.

U shpall në Tiranë sot me dt. 03.07.2014 ora 10.55

SEKRETARE
Olivia MYFTIU

GJYQTAR
Bardhyl DHAMA